

## **Privatësia dhe Cookies në Web4Jobs.**

### **E përgjithshme**

Përdorimi i të dhënave personale në faqen Web4Jobs, tutje referuar si “NE”, është rregulluar në përputhje të plotë me standardet më të larta për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të aplikuara Ballkan dhe se ne jemi organizatë jo-fitimprurëse, respektivisht web4jobs është ueb faqe jo-fitimprurëse.

Ne besojmë që ju keni të drejt për të kontrolluar përdorimin e informacioneve tuaja personale dhe privatësia juaj duhet respektuar. Ne kufizojmë qasjen dhe procedimin e të dhënave tuaja prej palëve të tjera. Ne nuk do përdorim të dhënat personale në një mënyrë që nuk përputhen për qëllimin që na i keni dhënë. Ne mundohemi të mbledhim sa më pak të dhëna personale në mënyrë që të arrijmë qëllimin e këtij projekti.

Ju keni të drejtë të kërkonin nga ne të mos i procedojmë dhe/ose përpunojmë të dhënat e juaja personale. Ju mund të ushtroni të drejtën tuaj për të parandaluar përpunimin e të dhënave me mos-miratim aty ku shfaqet dhe/ose kërkohet në kutitë e caktuara të formave që përdorim për raportime të ankesave apo të kontaktit.

Më poshtë ne do të ta përshkruajmë praktikën e grumbullimit të të dhënave përmes aplikacionit Web4Jobs;

### **Komunikimi me postën elektronike**

Email-et e pranuar shikohen nga anëtari gjegjësisht dhe dërgohen tutje kur është e nevojshme për anëtarët e tjerë brenda në organizatë. Në mënyrë të ngjashme edhe postat elektronike (E-maillet) të cilat dërgohen në adresat tona shikohen dhe fshihen sa më shpejt që është e mundur. Ne nuk do t'i zbulojmë emrat e dërguesve tek palët e treta, pa lejen tuaj.

### **Mbledhja e të dhënave përmes formave të kontaktit në ueb faqe**

Të dhënat që mbledhen përmes formave të aplikueshme në këtë ueb faqe siç janë emri; mbiemri; e-mail; telefoni; përmbajtje tekstuale; fajllat e ngarkuar. Të dhënat mbeten vetëm për komunikim tonë të ndërsjellë. Për arsyetimin se në këtë projekt, kjo faqe ka për komponent punësimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor aty ku kërkohet dhe është e domosdoshme, gjithmonë do të kërkohet leje nga ju për miratim në adresimin e secilit raportim që e dërgoni në ueb faqen web4jobs. Përmbajtjet e dërguesve përmes postës elektronike ose ueb aplikacionit, në serverët tan ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 3 vit.

### **Regjistrimi i anëtarëve**

Për përdorimin e veglave online apo shërbimeve, ueb aplikacioni aplikon regjistrimin e përdoruesve.

### **Cookies (biskotat)**

Ne përdorim Cookies të cilat kanë për qëllim përmirësimin e eksperiencës së përdoruesve si dhe përmirësimin e karakteristikave funksionale të aplikacionit tonë në internet.

Cookies që përdorim skadojnë brenda një (1) muaji dhe janë vetëm për monitorim të trafikut tonë në internet. Këta Cookies, paraqesin vetëm numra agregatë të shkarkimeve të secilit dokument, faqe, etj.

Ne gjithashtu përdorim një cookie për menaxhimin e sesionit tuaj: nëse paraqitni një formular, një sesion cookie mund të jetë vendosur për t'ju lejuar të konfirmoni një ri-paraqitje. Sistemi i menaxhimit të përmbajtjes në faqen tonë lë një cookie për administrimin e sesionit tuaj, por nuk përdoret për qëllime gjurmuese (përcjellëse).

Për monitorimin e trafikut, ne përdorim shërbimet e “Google Analytics” dhe qëllimi i vetëm është rritja e performancës së platformës dhe eksperiencës së përdoruesve. Asnjë përdorim tjetër nuk behët prej të dhënave të mbledhura, dhe se dhënat nuk kalohen të palët e treta.

Çdo herë që vizitoni një faqe në web4jobs.com dhe çdo herë kur shkarkoni një file, informacionet e aktivitetit janë të proceduara dhe të ruajtur në protokoll të përkohshëm.

Të dhënat renderohen në mënyrë anonime përmes shëndërrimit në IP adresë.

Informacionet në vazhdim ruhen meqë në rast kur ju vizitoni ose shkarkoni një faqe:

- Specifikat teknike të përdorimit të shfletuesit
- IP adresa anonime
- Koha dhe data
- Faqja e hapur/emri i file të shkarkuar

Ju mund të refuzoni përdorimin e cookies duke rregulluar shfletuesin tuaj dhe të ndaloni mbledhjen e të dhënave. Ju gjithashtu mund të parandaloni të mblidhen të dhënat e gjeneruara nga cookies dhe që lidhen gjatë përdorimit të internetit (përfshirë IP adresën) në Google dhe përpunimin e këtyre të dhënave nga Google, duke shkarkuar shtesën e shfletuesit në dispozicion në linkun e mëposhtëm:

<https://tools.google.com/dlpage/gaoptout>

Për më shumë informacion në lidhje me Google Inc dhe [Google Analytics](#), shkoni në: <https://www.google.com>.

Për të u informuar për politikat e privatësisë së Google, ju mund të vizitoni linkun më poshtë, ose të shfrytëzoni burime alternative të këtij ofruesi të shërbimeve në internet: <https://google.com/chrome/browser/privacy/>

## **Rrjetet Sociale**

Ne përdorim rrjete sociale me qëllim që të komunikojmë me publikun në internet. Këto aplikacione kërkojnë përdorimin e ofruesve të shërbimeve për palët e treta ose ndryshe

përdoruesit (userat). Ne përdorim shërbimet e ofruara në formë të ndërfaqeve të komunikimit me publikun përmes Facebook.com, LinkedIn dhe Twitter.com. Faqet në rrjetet sociale administrohen veç e veç nga Facebook.com, LinkedIn dhe Twitter.com, në përputhje me politikën e përdorimit dhe shfrytëzimit të shërbimeve të tyre, dhe janë të arritshme nga përdoruesit që tashmë kanë miratuar politikën e privatësisë së Facebook-ut, LinkedIn dhe/ose Twitter.com. Faqet e grupit menaxhohet nga anëtarët e stafit tonë.

### **Modifikimet e rregullave të privatësisë**

Në rast se ndryshojnë rregullat e privatësisë ne shfaqim kohën, datën, dhe natyrën ku tregohet qartë në këtë dokument për rregullat e reja.

### **Pyetjet**

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me privatësinë ose ndonjë sqarim, ju lutem na kontaktoni në: [info@web4jobs.info](mailto:info@web4jobs.info).

Ndryshimi i fundit: 1 shtator 2018.